

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i Prokurimit: 2025/UA/2016-25-4995-1-1-1/B05-0012976

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me artikuj ushqimor**

ANKESË

Identifikimi i ankuesit*

ADA Distribution L.L.C.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hasan Prishtina 10, Lokali 5

(Adresa)

PRISHTINË 10 000

(Vendi) (Kodi postar)

+38349847704

(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

FATON ÇITAKU


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

adadistribucion@gmail.com

(Adresa elektronike)

29.08.2025

(Data e parashtrimt të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Nuk aplikohet
Adresa e plotë	Nuk aplikohet
Numri i Telefonit	Nuk aplikohet
Numri i faks-it	Nuk aplikohet
Adresa elektronike	Nuk aplikohet

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Kontratë Kornize - Shërbime	Kontratë Kornize - Shërbime
Lloji i procedurës së prokurimit:	Lloji i procedurës së prokurimit:
Procedure e HAPUR	Procedure e HAPUR
Klasifikimi sipas vlerës:	Klasifikimi sipas vlerës: Vlerë e MADHE, 5,790,000.00€
Publikim i Njoftimi për kontratë:	Publikim i Njoftimi për kontratë:
Kriteri i dhënies së kontratës:	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
• B05 Njoftim për Kontratë me date 09.06.2025 • Proces verbal i hapjes date 22.07.2025 • Njoftimi mbi vendimin e AK date 13.08.2025 • Kërkesa për rishqyrtim 08.08.2025 • Vendim refuzimi i kërkesës për rishqyrtim date 11.08.2025 • Kërkesa për rishqyrtim 18.08.2025 • Vendim refuzim i kërkesës për rishqyrtim 21.08.2025	

4. Procesi i Hapjes së tenderëve,

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë:

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-diskriminimi
- Neni 10 – Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 53 – Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 – Kriteret për Dhënie të Kontratës
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Deklaratë dhe arsyetim

Shpërblimi i kontratës me çmim më të lartë

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shpërblyer kontratën me një Operator Ekonomik (OE) tjetër, ndonëse oferta e tij ishte dukshëm më e shtrenjtë se oferta jonë. Ky veprim është në kundërshtim me Nenin 1 të LPP-së, i cili përcakton se fondet publike duhet të përdoren në mënyrë **efikase dhe ekonomike**.

Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

Në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, AK nuk ka trajtuar ofertuesit në mënyrë të barabartë. Oferta jonë është eliminuar me arsyetimin se lista e çmimeve ishte e palexueshme për shkak të cilësisë së dobët të skanimit. Ky ishte një problem teknik, i padashur nga ana jonë, që në asnjë rast nuk cenon vlefshmërinë e ofertës.

Ligji i Prokurimit Publik i ka mundësuar AK-së të kërkojë **sqarime ose informata shtesë** (Neni 53 dhe Neni 72), por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Nëse një sqarim do të ishte kërkuar, ne do të kishim dorëzuar menjëherë dokumentacionin origjinal, të qartë dhe pa paqartësi.

Vlen të theksohet se oferta jonë ishte **80,078.30 € më e lirë** se oferta e shpallur fituese. Eliminimi i saj ka sjellë dëm të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit.

Transparenca

Sipas Neni 10 të LPP-së, AK ishte i obliguar të përdorte mjete transparente për të vërtetuar saktësinë e të dhënave. Ne kemi dorëzuar si listën e çmimeve, ashtu edhe formularin e ofertës me çmimet finale, që mund të krahasohen lehtësisht me versionin e ngarkuar në sistemin e e-prokurimit. Kjo nuk është marrë parasysh.

Ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderëve

Në kundërshtim me Nenin 59 dhe Nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar informata shtesë gjatë procesit të ekzaminimit të tenderëve. Eliminimi i ofertës është bërë pa ndjekur një proces të drejtë dhe pa një bazë të plotë verifikimi. Në trajtimin e kërkesës

sonë për rishqyrtim, AK ka pohuar – duke aluduar në një dokument të caktuar – se lista e çmimeve e ngarkuar nga ne ka pasur një emërtim të ndryshëm nga dokumenti i dorëzuar në Dosjen e Tenderit. Në këtë rast, me përgjegjësi të plotë ju konfirmojmë se kjo ka qenë vetëm një çështje teknike e lidhur me procesin e skanimit, e cila ka kaluar pa u vënë re në momentin e ngarkimit.

Megjithatë, të gjitha dokumentet tjera e dëshmojnë qartë se çmimi i ofertuar sipas listës është në përputhje të plotë dhe unik me çmimin e ngarkuar në sistem.

Kriteret për dhënien e kontratës

Në përputhje me **Nenin 60 të LPP-së**, kontrata është dashur të shpërblehej me ofertën më të lirë dhe të përgjegjshme. Oferta jonë plotësonte këtë kriter, prandaj vendimi për eliminim është i **padrejtë dhe i kundërligjshëm**.

Kërkesat tona

Në bazë të argumenteve të paraqitura:

KËRKOJMË nga eksperti shqyrtues dhe paneli i OSHP që pretendimi ankimor të trajtohet sipas ligjit dhe Autoriteti Kontraktues të marrë këtë:

VENDIM

1. Të aprovohet në tërësi si e **bazuar** ankesa jonë;
2. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës;
3. Lënda të kthehet në **ri-vlerësim**, në përputhje me kriteret ligjore dhe dokumentacionin e tenderit.

Dëmet materiale

Në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, përkatësisht seksionin e FDT-së dhe Aneksin 1 – Specifikimet Teknike, eliminimi i ofertës sonë shkakton **humbje të konsiderueshme ekonomike**, duke cenuar fitimin e parashikuar për këtë kontratë dhe duke dëmtuar konkurrencën e drejtë.

Dokumentet e bashkangjitura

- Lista e çmimeve e dorëzuar nga ADA Distribution L.L.C.
- Formulari i ofertës me çmimet finale
- Kopjet e dokumenteve të ngarkuara në sistemin e e-prokurimit